



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr. 54/2021

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, znj. Diellza Hoxha dhe z. Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat z. _____, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore në _____ pas mbajtjes së seancën dëgjimore publike në të cilën prezantuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj, Fadile Hoxha, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, pala ankuese, z. _____, si dhe përmbaruesi privat, z. _____ dhe pas seancës këshillimore, me shumicë votash, me datën 24.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-54/2021, date 23.11.2021, dhe ankesa e palës ankuese z. _____, dt 17.11.2021, si të pasafatshme.

A R S Y E T I M

Me datën 17.11.2021, pala ankuese z. _____ ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë kundër përmbaruesit privat z. _____, organ përmbarues i emëruar për Territorin e Gjykatës Themelore në _____. Pala ankuese pretendon që përmbaruesi privat ka bërë shkelje disiplinore duke vepruar në kundërshtim me nenin 9, nenin 10 pika 4, nenin 38 pika 1, nenin 43, nenin 47 pika 2 dhe nenin 323 pika 1, të Ligjit për Procedurën Përmbarimore. Pala ankuese thekson që përmbaruesi privat z. _____ i ka sekuestruar asetet atij si palë debitore pa i gjeneruar një kopje të procesverbalit për të si pronar e asetëve të sekuestruara. Po ashtu, i njëjti ka tjetërsuar asetet duke i shitur ato pa informuar palën debitore. Sipas palës ankuese, përmbaruesi privat ka sekuestruar asete që kapin vlerën prej 52,000.00 euro, ndërsa obligimet e tij ishin në vlerë prej 17,000.000 euro. Pala ankuese pretendon që përmbaruesi privat z. _____ nuk i ka kthyer shumën përtej obligimit të tij.

Me datën 23.11.2021, Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat ka paraqitur Raportin Përfundimtar ndaj përmbarruesit privat z. duke propozuar Komisionit Disiplinor që në përputhje me nenin 373 të LPP-së të ndërmarr veprimet e nevojshme.

Përmbarruesi privat z. në përgjigjen e tij deklaron se me datën 18.01.2017, kreditori: TEB Sh.A, me seli në Prishtinë, ka paraqitur Propozim për Përmbarrim për sekuestrimin e pengut dhe bllokimin e llogarive bankare. Sipas përmbarruesit privat, kreditori i ka bashkangjitur propozimit për përmbarrim dokumentin përmbarrimor: marrëveshjen për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut e dt 28.02.2014, nr 35794, si provë. Përmbarruesi privat thekson se përmbarrimi, në këtë rast, është lejuar me urdhrin P. nr 6/17, të datës 18.01.2017. Gjatë zbatimit të përmbarrimit, sipas përmbarruesit privat, me datën 12.01.2018 është përpiluar procesverbal me të cilin konstatohet se është sekuestruar pjesërisht pengu i luajtshëm (dy karrige për stomatologji, telekamera, aparatura mbajtëse, raftet, lavaboja me pajisjet e veta, makina e distilimit dhe pajisjet përcjellëse) për mos pagesë të borxhit dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore. Shton se pengu i është dorëzuar kreditorit në pajtim me dispozitat e Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore nr 03/L-154.

Me datën 21.12.2021, Komisioni Disiplinor ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, z. Fadilete Hoxha, pala ankuese z. dhe përmbarruesi privat, z.

Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, ka bërë shtjellimin e Raportit Përfundimtar ndaj përmbarruesit privat duke theksuar se mbetet pranë tij. Po ashtu, edhe pala ankuese z. dhe Përmbarruesi privat z. kanë paraqitur qëndrimet e tyre respektive.

Komisioni me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas kërkesës dhe pranimit të provave shtesë nga pala ankuese z. vjen në përfundim se ankesa është e pasafatshme.

Komisioni Disiplinor gjen me rëndësi të thekson që neni 375 i LPP-së, shprehimisht përcakton që *“procedura disiplinore (ndaj përmbarruesit privat theksimi i shtuar) mund të fillohet brenda afatit prej gjashtë (6) muaj nga dita e shkeljes së bërë, por jo më vonë se një (1) vit nga dita e shkeljes.”* Kjo do të thotë se procedura disiplinore më së voni mund të fillohet brenda një (1) viti nga dita e shkeljes së pretenduar disiplinore. Nëse ndonjë pasojë që përbën element të veprës disiplinore shfaqet më vonë, afati fillon të rrjedh nga ajo kohë. Në rastin në fjalë, parashtruesi pretendon që përmbarruesi privat z. ka bërë shkelje disiplinore duke vepruar në kundërshtim me nenin 9, nenin 10 pika 4, nenin 38 pika 1, nenin 43, nenin 47 pika 2 dhe nenin 323 pika 1 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore. Siç u theksuar më lartë, pala ankuese thekson që përmbarruesi privat z. i ka sekuestruar asetet e tij si palë debitore pa i gjeneruar një kopje të procesverbalit për të si pronar e asetëve të sekuestruara. Po ashtu, pala ankuese pretendon që i njëjti i ka tjetërsuar asetet duke ia shitur pa e informuar. Sipas palës ankuese, përmbarruesi privat ka sekuestruar asete

që kapin vlerën prej 52,000.00 euro, ndërsa obligimet e tij ishin në vlerë prej 17,000.000 euro. Pala ankuese pretendon që përmbaruesi privat z. nuk i kthyer shumën përtej obligimit të tij. Komisioni Disiplinor gjen se me datën 18.01.2017, kreditori: TEB Sh.A, me seli në Prishtinë, ka paraqitur Propozimin për Përmbarim për sekuestrimin e pengut dhe bllokimin e llogarive bankare. Marrëveshja për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut, nr 35794, mbanë datën 28.02.2014. Përmbarimi në këtë rast është lejuar me urdhrin P. nr 6/17, të datës 18.01.2017. Veprimet përmbarimore të ndërmarra nga përmbaruesi privat me të cilin konstatohet se është sekuestruar pjesërisht pengu i luajtshëm (dy karrige për stomatologji, telekamera, aparatura mbajtëse, raftet, lavaboja me pajisjet e veta, makina e distilimit dhe pajisjet përcjellëse), janë ndërmarr me datën 12.01.2018, siç evidentohet nga procesverbali i cili gjendet në shkresat e lëndës. Rrjedhimisht, shkeljet e pretenduara i referohen urdhrin përmbarimor P. nr 6/17, të datës 18.01.2017 dhe veprimeve përmbarimore të ndërmarra me dt 12.01.2018, dhe si të tilla, për këto shkelje ka kaluar afati prej një (viti) brenda të cilit mund të fillohet procedura disiplinore pranë Komisionit Disiplinor.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.nr 54/2021, datë 24.12.2021

Kryesues i Komisionit Disiplinor
Adnan ISUFI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.

